

VENDIM
Nr. 130, datë 4.6.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” SHA (“FTL” SHA), PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, protokolluar me tonën nr. 355 prot., datë 30.4.2018, OSHEE sh.a., ka përcjellë në ERE dokumentacionin për transferimin dhe licencimin e shoqërive të kontrolluara nga ana e saj. Ndër to, është edhe dokumentacioni i shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. (FTL sh.a.), për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 2 prot., datë 27.4.2018, “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. (“FTL” sh.a.), ka paraqitur në ERE një kërkesë për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 1090/1 prot., datë 6.4.2018 të OSHEE sh.a. është bërë me dije se shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. (“FTL” sh.a.), është themeluar si shoqëri e kontrolluar, në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018, të shoqërisë OSHEE sh.a., në cilësinë e aksionarit themelues dhe **shoqërisë mëmë**. Data e themelimit është 28.3.2018.

- Aplikimi i shoqërisë “FTL” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”), plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”), plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “b”, “c”, “d”), plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat “b”, “c”), plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë);
- Nenin 9, pika 3, germa “a” (vërtetime që shoqëria nuk ka detyrime për tatim-taksa dhe ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore);

- Nenin 9, pika 4.8, germa “a” (sasia e energjisë elektrike që parashikohet për t’u tregtuar) dhe germa “d” (sasitë e energjisë elektrike që do të tregtojnë sipas viteve), do të do të njoftohet shoqëria që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, neni 11, pika 1, t’i paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. (“FTL” sh.a.), në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

